

## KËRKIME GJUHËSORE

---

Manjola BREGASI

### RRETH EKONOMISË GJUHËSORE NË LEKSIK: FJALËT E PËRNGJITURA

Koncepti i ekonomisë në gjuhësi mund të ketë vlera dhe kuptime të ndryshme e mund të studiohet gjithashtu nga këndvështrime të ndryshme. Nga pikëpamja leksikore dhe etimologjike, fjala ekonomi në një kuptim të përgjithshëm do të thotë: fitim, kursim, më pak ngarkesë, më pak mund. Ajo vjen nga fjala greke *oikòs*, që do të thotë shtëpi dhe *nomòs*, që do të thotë të shpërndash. Ky bashkim, që çon në konceptin e menaxhimit të mirë të burimeve në një shtëpi mund të transferohet në mënyrë metaforike në nivelin social, por edhe në atë gjuhësor. Për këtë arsye ekonomia në gjuhë ka një funksion të fortë kontrollues mbi të gjithë sistemin, duke realizuar informacionin me sa më pak energji.<sup>1</sup> Sa më pak mund<sup>2</sup>. Kështu e nis Andre Martinet, kapitullin për ekonominë gjuhësore në studimin e tij “Elementë të gjuhësisë së përgjithshme”, duke na bërë të njohur, se: në çdo stad të zhvillimit, vendoset një lloj ekuilibri midis nevojave të komunikimit që kërkojnë njësi më të shumta, më specifike, çdonjëra nga të cilat del më rrallë në thënie dhe inercisë së njeriut që shpie në përdorimin e një numri të rrudhur njësisht me vlerë më të përgjithshme dhe me një përdorim më të dendur.<sup>3</sup> Në këtë pikëpamje, “sa më shumë informacion, me sa më pak mund e sforco”, ligji i ekonomisë gjuhësore shihet të veprojë në të gjitha nënsistemet e gjuhës, madje edhe në atë leksikor. Në radhë të parë, ky ligj e gjen veten tek polisemia, sepse kemi vetëm 1 shënues për 2 ose më shumë të shenjuar. Le të marrim p.sh. fjalët: *çerdhe* (për fëmijët, për zogjtë, për fjalët, për spiunët), *çel* (lulja, sytë, derën, ) *shtraj* (qilimin, petët, darkë, rrugën, çështje, etj.)

Por, një nga dukuritë më interesante të ekonomisë gjuhësore, lidhur pazgjidhshmërisht me procesin e fjalëformimit është grupi paradigmatic i fjalëve të krijuara me përngjitje. Është ky grup, në të cilin do të ndalemi më hollësisht duke marrë ngacmim nga studimi i profesoreshë Ludmila Buxheli, “Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe”. Kjo vepër, na jep një informacion të plotë për fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe duke u dhënë përgjigje shumë çështjeve të lidhura me këtë mënyrë fjalëformimi, parë kjo, si në rrafshin sinkronik edhe në atë diakronik. Këtu edhe një herë, hidhet poshtë mendimi se gjuha shqipe nuk ka fjalë të përngjitura, ndërsa argumentohen rrethanat e krijimit, veçoritë fjalëformuese, dallimi i tyre nga lokucionet apo fjalët e krijuara me mjete morfologjike, etj. Studimi i profesoreshë Buxhelit, na jep mundësinë të njohim më mirë përngjitjen dhe njëkohësisht të shohim zbatimin e ekonomisë gjuhësore në këtë mënyrë fjalëformimi.

---

<sup>1</sup> Alessandra Vicentini , <http://www.ledonline.it/mpw/>.

<sup>2</sup> A. Martinet, Elementë të gjuhësisë së përgjithshme, Tiranë, 2002, f. 149.

<sup>3</sup> A. Martinet, Elementë të gjuhësisë së përgjithshme, Tiranë, 2002, f. 149.

**Çfarë është përngjitja?** Në vija të përgjithshme, përngjitja mund të përcaktohet si një mënyrë fjalëformimi nëpërmjet së cilës krijohen fjalë të reja nga përngjitje fjalësh të një sintagme, me vlerën e një togfjalëshi, togu parafjalor ose të një fjalie si dhe nga përngjitja e fjalëve të një grupi fjalësh, të cilat në procesin e ngjizjes ruajnë në formë të ngurosur lidhjet sintaksore, formën gramatikore, ndonjëherë treguesit eptimorë dhe kuptimin.<sup>4</sup> Bazuar në këtë përkufizim dhe duke u nisur nga ligji i ekonomisë gjuhësore, “sa më pak mund e sforco, aq më shumë informacion” ne mund të flasim për ekonomi në rastin e fjalëve të përngjitura, sepse kemi kalim nga një sintagmë në një fjalë të vetme. P.sh. *luledielli, paradite, farefis, gjëgjëzë, qoftëlargu*, etj. Duke funksionuar si një fjalë e vetme, këto njësi leksikore shënojnë mbylljen e strukturës, marrin treguesit eptimorë të një fjale, duke shënuar në këtë mënyrë sintetizim të mjeteve leksikore, çka përbën një shprehje të ligjit të ekonomisë gjuhësore. Le të krahasojmë psh: *kuq e zi – kuqezi, fol e qesh- foleqesh, tungjatjeta- t’u ngjattë jeta*. Ndryshe nga njësitë përbërëse të togfjalëshave apo togjeve parafjalore të qëndrueshëm, që nuk e kanë humbur mëvetësinë dhe struktura është e hapur, në fjalët e përngjitura kemi njëfjalëzim ose leksikalizim të këtij togfjalëshi apo togu parafjalor. Gjatë procesit të leksikalizimit, njësitë motivuese të fjalëve të përngjitura përdoren së bashku për një kohë të gjatë e më pas formësohen gramatikisht.

Kështu p.sh. krahasojmë fjalët: *luledielli, vërej, shkel e shko*, etj., me togfjalëshat e qëndrueshëm *lule dielli, vë re, shkel e shko*, etj. Në disa raste, me të njëjtin kuptim leksikor përdoren si fjalët ashtu edhe togfjalëshat.

Mjaft interesant nga pikëpamja e ekonomisë gjuhësore është edhe zëvendësimi i disa togfjalëshave foljorë me folje të përngjitura, si p.sh:

*sjell ndër mend- ndërmend*

*rrok në gushë- ngushon*

*e ngre më këmbë- mëkëmb*

*marr nëpër këmbë – nëpërkëmb*

“Zhvillimi gjuhësor mund të konceptohet si i drejtuar nga kontradikta e përhershme midis nevojave komunikuese të njeriut dhe prirjes së tij për ta rrudhur në minimum veprimin mendor dhe fizik” – shkruan A. Martine<sup>5</sup>. Fakti, që kuptimi i këtyre foljeve të përngjitura është i njëjtë me kuptimin e sintagmës nga ato kanë dalë shpreh qartë prirjen për sintetizimin e mjeteve të shprehjes. Kemi të bëjmë me atë që Martine e cilëson si ekonomi sintagmatike: (e ngre më këmbë- mëkëmb) 6 fonema në vend të 12 të tillave dhe 2 monema në vend të 4 të tillave.

Një tjetër fenomen që vihet re gjatë fjalëpërngjitjes, i lidhur gjithashtu me ekonominë gjuhësore, është procesi i errësimit të valencave leksiko-sintaktike.

Pranohen 3 shkallë të errësimit të valencave:

- A. Valenca të lira, kur fjalët lidhen lirshëm e krijojnë sintagma të lira, p.sh. *lule e bukur*.

<sup>4</sup> L. Buxheli, Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe, Tiranë, 2009, f. 66.

<sup>5</sup> A. Martinet, Elemente të gjuhësisë së përgjithshme, Tiranë, 2002, f. 149.

## RRETH EKONOMISË GJUHËSORE NË LEKSIK: FJALËT E PËRNGJITURA

- B. Valenca gjysmë të errësuar, siç janë rastet e njësive frazeologjike, ku eptimi është i gjymtë dhe rendi i fjalëve i ngulitur, p.sh. *i bie këmbës, iu bë gjaku ujë*, etj.
- C. Valenca të errësuar plotësisht, siç është rasti i fjalëve të përngjitura dhe veçanërisht i lidhëzave. Në lidhëzën *meqenëse*, folja *jam* (me qenë) është errësuar krejtësisht nga kuptimi i saj.

Kjo do të thotë se me të njëjtat mjete gjuhësore, ne arrijmë të krijojmë fjalë të reja, me një kuptim të ri, ku njësitë përbërëse e kanë humbur kuptimin e tyre.

Shpesh në fjalët e përngjitura gjejmë edhe errësime në strukturën fonetike të përbërësve, qofshin ato në rrokje apo tinguj, si p.sh. *shtojzovalle – shtoji zot vallet*, ku ka rënë bashkëtingëllorja *t*, apo tek pasthirrmat e tipit *lamtumirë- lamë këtu mirë, mirëmbërëma*, që sipas profesoreshë Buxhelit, duhej të ishte *mirëmbërëma*. Një rast i veçantë është pasthirrma *tungjatjeta – t'u ngjattë jeta*, e cila motivohet me një fjali të plotë dykryegjymtyrëshe. Njëfjalësimi i kësaj fjalie në një fjalë të vetme është gjithashtu tregues i ekonomisë gjuhësore: sa më shumë informacion, me sa më pak mund. Ky fenomen, i rënies së tingujve vihet re edhe tek mbiemrat e përngjitur të tipit *kuqezi*, ku nyja e përparme nuk ruhet gjatë përngjitjes, (i) kuq e (i) zi.

Në fund të fundit, përngjitja nënkupton një proces historik gjatë të cilit fjalët e një sintagme kthehen në një fjalë të vetme, të shoqëruar me ndryshime fonetike, morfologjike dhe më kryesoja me formësime semantike dhe rikuptimësim të njësisë së re, që nuk është shumë e përbërësve të sintagmës. Të gjithë këta elementë që shfaqen në procesin e përngjitjes dhe vetë fakti, që shënojmë kalimin nga sintagma apo togfjalëshi në një njësi të vetme leksikore janë tregues të zbatimit të ligjit të ekonomisë gjuhësore edhe në fjalët e përngjitura.